



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 04 prill 2012  
Nr. ref.: RK 216/12

## **AKTVENDIMI PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin nr. KI 98/10**

Parashtruesi

**Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve 01 nr. 06/837, të datës 16 prill 2009, dhe Npi-01/132, të datës 30 prill 2009, të Kuvendit Komunal të Shtimes**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës është Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Avokati i Popullit) i cili në pajtim me nenin 113.2.2 të Kushtetutës ka parashtruar kërkesën në rastin e znj. Lelica Ristiç, me vendbanim në Jagodinë, Republika e Serbisë.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston vendimet e Kuvendit Komunal të Komunës së Shtimes, 01 nr.06/837, të datës 16 prill 2009 dhe Npi-01/132, të datës 30 prill 2009.

## **Objekti i çështjes**

3. Parashtruesi pohon se janë shkelur neni 36 [E drejta në privatësi] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe neni 8.1 [E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare], dhe neni 14 [Ndalimi i diskriminimit] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: Konventa).

## **Baza juridike**

4. Neni 113.2 (2) i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

5. Më 7 tetor 2010, parashtruesi ka dorëzuar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 16 dhjetor 2010, Kryetari, me Urdhërin Nr. GJR.98/10, emëroi gjyqtarin Kadri Kryeziu si Gjyqtar raportues. Po të njëjtën ditë, me Urdhërin e Kryetarit Nr.KSH.98/10, është emëruar Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët Almiro Rodrigues (kryesues), Gjyljeta Mushkolaj dhe Iliriana Islami.
7. Më 17 janar 2011, njoftimi për kërkesën e parashtruar i është dërguar Kuvendit Komunal në Shtime (në tekstin e mëtejme: Kuvendi Komunal).
8. Më 13 maj 2011, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe shumica rekomandoi papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

9. Më 30 dhjetor 1996, Kuvendi Komunal ka marrë vendim me Nr. 01 nr.360/659 që zonjës Lelica Ristiq, si punonjëse e administratës komunale t'i ndajë në shfrytëzim për kohë të pacaktuar një banesë. Ndarja e banesës në fjalë është bërë nga komisioni për strehimin e punëtorëve në nevojë të administratës komunale të Shtimes, dhe u konfirmua me vendimin Nr. 01, 06-605/1, të datës 7 tetor 1996, dhe nr. 360/620, të datës 11 tetor 1996.
10. Znj. Ristiq në qershor të vitit 1999 kishte lëshuar Kosovën, për shkaqe sigurie dhe për shkak të situatës politike, dhe e njëjta ishte zhvendosur përkohësisht në Jagodine, Serbi.
11. Më 7 korrik 2008, znj. Ristiq, e shoqëruar nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës (në tekstin e mëtejme: PK) dhe zyrtarët e Zyrës ndërlidhëse me gjykata në Ferizaj, kanë vizituar banesën në fjalë, ku është vërtetuar se banesën e kishin zënë disa persona në mënyrë joligjore.
12. Znj. Ristiq, më 27 korrik 2008, e shoqëruar sërish nga zyrtarët e Zyrës ndërlidhëse është paraqitur në stacionin e PK-së në Shtime, ku edhe ka paraqitur një ankesë së bashku me

kopjen e vendimit 01, nr.360/659, të datës 30 dhjetor 1996, si dëshmi mbi të drejtën e shfrytëzimit të banesës.

13. Më 10 qershor 2009, znj. Ristiq ka parashtruar ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit në Prishtinë, kundër Kuvendit Komunal dhe Policisë së Kosovës, pasi që këta nuk ia kishin mundësuar asaj vendosjen në banesën e kontestuar, e cila ishte uzurpuar jashtëligjshëm nga pala e tretë.
14. Më 18 shtator 2009, parashtruesi i kërkesës ka vepruar mbi kërkesën e znj. Ristiq dhe i është drejtuar Kryeshefit të stacionit policor në Shtime, duke kërkuar nga i njëjti informacione lidhur me statusin e banesës në fjalë.
15. Më 22 tetor 2009, parashtruesi i kërkesës kishte marrë përgjigje nga Kryeshefi i stacionit policor në Shtime, i cili kishte njoftuar se Kuvendi Komunal në Shtime, me vendim 01-Nr.06/837, të datës 16 prill 2009, njëzëri ka miratuar vendimin për anulimin e vendimit Nr.01.nr.06/605/1 të Kuvendit Komunal të datës 7 tetor 1996, për ndarjen e banesave në “Objektin banesor-tregtar” në Shtime, ish-punëtoreve të administratës komunale për kohë të pacaktuar.
16. Sipas Kryeshefit të Policisë, pasi që Kuvendi Komunal kishte anuluar të drejtën e shfrytëzimit të banesës së kontestuar, e njëjta i është ndarë për banim mbajtësit të jashtëligjshëm. Znj. Ristiq, gjithashtu edhe bartësit tjerë të së drejtës në banesa të tilla, nuk kanë qenë të njoftuar lidhur me vendimin e lëshuar nga Kuvendi Komunal për anulimin e asaj të drejte.
17. Për më tepër, pasojat juridike të vendimit 01 nr. 06/837, të 16 prillit 2009, ishin zbatuar vetëm ndaj znj. Ristiq, pasi që banuesit tjerë të objektit në fjalë e mbajtën të drejtën e banimit.
18. Znj. Ristiq, pas marrjes së përgjigjes nga Kryeshefi i Policisë, i ka dorëzuar tërë dokumentacionin e nevojshëm parashtruesit të kërkesës, duke dëshmuar që është bartës i plotfuqishëm i të drejtës së banimit mbi banesën e kontestuar. Gjithashtu, e njëjta ka shtruar ankesë tek Zyra ndërlidhëse me gjykata në Ferizaj, të cilët së bashku me pjesëtarët stacionit policor në Shtime kanë dëbuar personin i cili jashtëligjshëm ka qëndruar në banesë.
19. Znj. Ristiq, më 26 shkurt 2010, i paraqiti kërkesë Zyrës së Kryeministrit, përkatësisht Zyrës për çështjen e komuniteteve, duke kërkuar *restitutio in integrum* (kthim të gjendjes së mëparshme) duke ia bashkëngjitur kopjen e vendimit nr.360/659, të datës 30 dhjetor, mbi të drejtën e shfrytëzimit të banesës së lartpërmendur. Lidhur me këtë kërkesë e njëjta nuk ka marrë asnjë përgjigje.
20. Po të njëjtën ditë, parashtruesi i kërkesës i shkroi Kryetarit të Komunës së Shtimes, duke kërkuar që i njëjti të paraqes arsyetimin e tij lidhur me bazën ligjore të vendimit Npi. 01/132, të lëshuar nga Kuvendi Komunal i Shtimes më 30 prill 2009, me anë të të cilit i është anuluar e drejta e znj. Ristiq dhe banorëve të tjerë në shfrytëzimin e banesave përkatëse në Komunën e Shtimes.
21. Më 16 mars 2010, parashtruesi i kërkesës ka marrë përgjigje zyrtare nga Kryetari i Komunës, në të cilën thuhet se baza ligjore për vendimin e lëshuar nga Kuvendi Komunal, mbi anulimin e të drejtës së banimit znj. Ristiq, ishte Kontrata me koncesion e lidhur midis Kuvendit Komunal dhe ndërmarrjes ndërtimore GP- “Gradevinar” (Ndërtimtari), nga Kraleva, Republika e Serbisë. Sipas Kryetarit, Kuvendi Komunal ka vepruar në pajtim me nenin 5 (b) dhe nenin 12 (2) (d) të Ligjit nr.30/L-040 për Qeverisjen Lokale.

## **Pretendimet e parashtruesit lidhur me rastin e znj. Ristiq**

22. Parashtruesi i kërkesës pohon se me Vendimin nr.01/132, të Kuvendit Komunal të Shtimes, znj. Ristiq i është mohuar e drejta e shfrytëzimit të banesës në fjalë, duke kryer kështu shkelje të nenit 36 të Kushtetutës.
23. Po ashtu, parashtruesi i kërkesës pretendon se është shkelur neni 36 i Kushtetutës në lidhje me nenin 8 [e Drejta për jetë familjare] dhe 14 [Parandalimi i Diskriminimit] KEDNJ.
24. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pohon se, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), banesa e kontestuar në këtë rast mund të konsiderohet si “shtëpi”, dhe ky interpretim vije nga neni 8 i KEDNJ (*shih Gilloë kundër Mbretërisë së Bashkuar, Aktgjykimi i datës 24 nëntor 1986*). Gjithashtu në rastin Larkos kundër Qipros, Aktgjykimi nr.2951/95, GJEDNJ 1999-I, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut i është referuar konkretisht neni 14 në lidhje me nenin 8, ku thuhet se e drejta e banuesit që të banojë në një vend të caktuar përmban të drejtën në shtëpi dhe jo të drejtën në pronësi.
25. Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës pretendon se është shkelur neni 14 në lidhje me nenin 8 të KEDNJ, sepse nuk është vepruar drejt nga Kuvendi Komunal i Shtimes pasi që i njëjti kishte marrë vendim për anulimin e të drejtës së banimit znj. Ristiq, përderisa banuesit tjerë e gëzojnë ende të drejtën e shfrytëzimit të banesës. Banesa të cilën e ka pas në shfrytëzim znj Ristiq, i është dhënë mbajtësit të jashtëligjshëm. Në lidhje me këtë fakt, parashtruesi i kërkesës thirret në vendimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, konkretisht në rastin Larkos kundër Qipros, Aktgjykimi nr. 2951/95, GJEDNJ 1999-I, ku Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut dhe GJEDNJ kanë qenë të mendimit se kishte ardhur deri te shkelja e nenit 14 të KEDNJ në lidhje me nenin 8 të KEDNJ. Kështu që, parashtruesi i kërkesës konsideron që nuk ka ekzistuar arsyetim i racional dhe objektiv që znj. Ristiq t'i mohohet e drejta që gëzojnë banuesit e tjerë.
26. Po ashtu, parashtruesi i kërkesës i referohet neni 2.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 mbi kërkesat Pronësore Banësore, të 31 tetorit 2000, në të cilën thuhet: “Çdo e drejtë në pronë që është fituar në pajtim me ligjin në fuqi në kohën e fitimit të saj, mbetet e vlefshme përkundër ndryshimeve të legjislacionit në fuqi në Kosovë, përveç rasteve kur kjo rregullore parasheh ndryshe”. Gjithashtu neni 6(b) i rregullores në fjalë citon:
- “.....
- (b) Pavarësisht nga dispozitat e çfarëdo ligji tjetër, asnjë e drejtë banimi në banesë shoqërore nuk mund të përfundojë:
- (i) Pa pëlqimin e bartësit të së drejtës për banim ose të Drejtorisë për çështje banësore dhe pronësore; ose
- (ii) Pa urdhëresën e Komisionit, siç parashtrohet me anë të kësaj Rregulloreje dhe...mungon teksti në vazhdim.
- ...”
27. Prandaj, parashtruesi i kërkesës thirret në ligjin në fuqi për Çështjet banësore përmes Rregullores së UNMIK-ut 2000/60, të datës 31 tetor 2000, për kërkesat pronësore banësore, Rregullores së punës, provave të Drejtorisë për Çështje Pronësore Banësore, si dhe Komisionit për Marrëdhënie Pronësore Banësore, duke deklaruar se, në rastin konkret, vendimet e Kuvendit Komunal nuk janë bazuar në ligjin në fuqi, sipas të cilit çdo

subjekt juridik dhe politik ka për obligim që ta respektoj sundimin e ligjit dhe qeverisjes së mirë në Kosovë.

28. Parashtruesi i kërkesës përfundon se Kuvendi Komunal i Shtimes, me marrjen e Vendimit 01 nr. 06/837, të datës 16 prill 2009, dhe vendimit Npi-01/132, të datës 30 prill 2009, nuk ka respektuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet në fuqi, si dhe Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës mendon se veprimet e Komunës së Shtimes, me anulimin e të drejtës së znj. Ristiç mbi shfrytëzimin e banesës dhe dhënien e saj në shfrytëzim mbajtësit të jashtëligjshëm, konsiderohet si cenim i parimeve të qeverisjes së mirë.

### **Vlerësimi për pranueshmëri**

29. Për sa i përket pretendimeve të parashtruesit se i janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me nenin 36 [E Drejta në Privatësi] të Kushtetutës si dhe nenin 8.1 [E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare] dhe nenin 14 [Ndalimi i diskriminimit] të KEDNJ, Gjykata vëren se, në mënyrë që kërkesa të jetë e pranueshme, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë se a i ka përmbushur parashtruesi i kërkesës të gjitha kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregulloren e punës.
30. Gjykata vëren se në pajtim me nenin 135.4 të Kushtetutës, “Avokati i Popullit mund t’i referojë çështje Gjykatës Kushtetuese në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute”. Neni 113.2, për më tepër, specifikon kur Avokati i Popullit është i autorizuar që të parashtroni kërkesë pranë Gjykatës.
31. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese vëren se parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kërkesën në lidhje me rastin e znj. Ristiç kundër vendimeve 01 nr.06/837, të 16 prillit 2009, dhe Npi-01/132, të 30 prillit 2009, të marra nga Kuvendi Komunal i Shtimes sipas nenit 113.2.2 të Kushtetutës i cili parasheh:

*“Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim: përputhshmëria e Statutit të Komunës me Kushtetutën”.*

32. Në këtë aspekt, Gjykata konkludon se vendimet e lartpërmendura të Kuvendit Komunal nuk paraqesin “Statutin Komunal” në kuptimin e nenit 113.2.2 të Kushtetutës, të cilët janë akte normative që rregullojnë kompetencat dhe organizimin e komunës si dhe marrëdhëniet mes komunës dhe qytetarëve në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe Ligjin, përderisa vendimet e marra nga Kuvendi Komunal në rastin e parashtruesit të kërkesës, përkundër statuteve, janë vendime të marra në një rast të veçantë të individit apo personit juridik.
33. Për më tepër, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës, me qëllim të sjelljes së një ankese kushtetuese në mënyrë që të ndiqen/paraqiten interesat individuale para kësaj Gjykate, nuk është palë e autorizuar sipas Kushtetutës. Parashtruesi i kërkesës si institucioni pavarur (Avokati i Popullit), në pajtueshmëri me nenin 133 [Zyra e Avokatit të Popullit] të Kushtetutës, është vetëm pala e autorizuar ajo që paraqet kërkesa për kontrollin abstrakt të kësaj Gjykate, në pajtueshmëri me nenin 113.2.2 të Kushtetutës.
34. Në këto rrethana, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit të kërkesës me të cilën kontestohen vendimet e Kuvendit Komunal të Shtimes nuk mund të gjykohej, pasi që çështja nuk ishte referuar në Gjykatë në mënyrë të ligjshme nga një palë e autorizuar, në pajtueshmëri me nenin 113.1 të Kushtetutës.



35. Sidoqoftë, një individ mund të parashtrojë kërkesë në Gjykatë, në pajtueshmëri me nenin 113.7. i cili parasheh:

*“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

....

Kështu që, nuk duket të ketë ndonjë arsye pse znj. Ristiq nuk ka mundur të paraqes kërkesën në këtë Gjykatë për rastin e vet.

36. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit është e papranueshme sipas nenit 113.2 (2) dhe 113.7 të Kushtetutës.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në pajtueshmëri me nenin 20 të Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 56(2) të Rregullores së punës, më 13 maj 2011, me votën e shumicës

### **VENDOS**

- I. TA REFUZOJË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t’u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtueshmëri me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari Raportues**

  
Kadri Kryeziu



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

  
Prof. Dr. Enver Hasani